



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura e III-të**

**Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion;**

Mbledhja nr.13/2008;  
më 12.06.2008, në ora 11:00;  
Ndërtesa e Kuvendit, Salla C-203;

**Procesverbal**

Në mbledhje morën pjesë: Et'hem Çeku, Zef Morina, Fatmir Rexhepi, Safete Hadergjonaj, Sala Berisha – Shala, Haki Shatri dhe Berim Ramosaj;

Munguan: Slobodan Petroviq, Múfera Şinik dhe Kaqusha Jashari;

Përcjellës prezent: Hakif Jashari dhe Selvije Gjakova nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (Departamenti Ligjor), Banush Neziri nga Njesia e Akreditimit, Haxhi Gashi nga USAID, Petrit Hysa nga OSCE, Fitore Zeneli nga KDI, Blerina Uka nga NDI dhe Daut Beqiri Drejtor i Departamentit Ligjor/Kuvendi i Kosovës;

Nga zyra mbështetëse: Armend Ademaj dhe Besim Haliti;

Mbledhjen e drejtoi: Myzejene Selmani – Kryetare e Komisionit

Për këtë mbledhje është propozuar ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Ndryshimin e Ligjit Nr.02/L-43 për Akreditim;
4. Të ndryshme;

### **I. Miratimi i rendit të ditës;**

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

### **II. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**

Procesverbali i mbledhjes së kaluar u miratua pa vërejtje.

### **III. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Ndryshimin e Ligjit Nr.02/L-43 për Akreditim;**

**Kryetarja** - informoi të pranishmit se duhet nga ana e Komisionit të ipet një rekomandim në lidhje me Shqyrtimin në parim i Projektligjit për Ndryshimin e Ligjit Nr.02/L-43 për Akreditim, i cili do të dal në seancën e ardhme për miratim në parim. Mirëpo ua kaloj fjalën përfaqësuesve të Ministrisë Tregtisë dhe Industrisë (në vijim MTI-ja) Departamentit Ligjor dhe përfaqësuesit të Njesisë së Akreditimit;

**Hakif Jashari (Departamenti Ligjor në MTI)** – ku në përgjithësi elaboroj Projektligjin për Ndryshimin e Ligjit Nr.02/L-43 për Akreditim, dhe spjegoj objektivat e këtij projektligji. Nder tjerash theksoj se Njësia e Akreditimit në kohën sa funksionon në bazë të ligjit të akreditimit, sipas ligjit në fuqi ka has vështirësi në punë dhe të tjerë, pasi që ajo varet direkt nga kryeshefi ekzekutiv të Agjencionit të Standartizimit, si nga buxheti ashtu edhe nga vendimarrja. Pra përderisa Njësia e Akreditimit duke qenë e mvarur nga ASK-ja e njëjta nuk mund të nënshkruaj marrëveshje multilaterale si dhe akreditimi ynë nuk njihet nga njësit e tjera të akreditimit në regjion. Qëllimi i këtij projektligji është që njësia e akreditimit të ndahet nga Agjencioni i Standardeve të Kosovës (ASK-ja) dhe të veproj si i pavarur në procedurat e akreditimit. Duke shtuar më tej së më këtë projektligj do të krijohen kushte më të favorshme dhe më harmoni me direktivat e BE-së.

**Kryetarja** - në diskutimin e saj tha se arsytja e ndryshimit apo zëvendësimit të ligjit si duket është të hasurit në vështirësi të natyrës subjektive, gjatë zbatimit të ligjit, nga fakti se zbatimi ka qenë i varur direkt nga kryeshefi ekzekutiv i Agjencionit, si thuhet në shkresën shpjeguese. Poashtu sipas memorandumit shpjegues tjetër arsye nuk ka, mirëpo shtrohet pyetja se a mund të tejkalohen vështirësitë e përmendura me shtimin e përgjegjësisë dhe vetë të subjekteve që secili të funksionojnë sipas ligjit dhe brenda ligjit. Një element tjetër që bëhet me menduar se a ka apo jo arsye për zëvendësimin apo ndryshimin e ligjit është edhe fakti se në mënyrë të ndryshme të ligjit e ka ndërmarr vetë Zyra Njësia e Akreditimit. Duke shtuar më tej Kryetarja se a do të jetë garantues vet fakti i pavarësisë të këtij autoriteti për zbatueshmërinë e ligjit edhe pse ky autoritet do të jetë në kuadrin e ministrisë, kur dihet se pavarësia e organit do të jetë e natyrës relative. Unë mendoj se vertet duhet vlerësuar arsyeshmërinë e organizimit të “pavarur” dhe të shëndrimit të kësaj zyre në departament. Këto dy elemente shëndrimi i zyrës së drejtorit – departament dhe themelimi i kështillit sipas logjikës së shtojnë numrin e nëpunësve dhe të udhëheqësve kurse si vlerësohet dispozita normative që përcaktojnë detyrat, përgjegjësitë si dhe procedurat, mbeten të njëjta. Në fund theksoj se shikuar në aspektin e plotësimit të kërkesave të standartizimit juridik, gjuhësor dhe teknik, projektligji përmbush kërkesat elementare edhe pse ka lëshim të cilat do të eliminohen duke shtuar se e mbështet miratimin në parim të këtij projektligji.

**Et'hem Çeku** – theksoj se në parim e mbështet projektligjin mirëpo shprehu brengosjen së është bërë një praktik jo e mirë që kur po hartohen ligjet mirëpo nuk po janë të zbatueshme dhe pas dy apo tri vjetëve, menjëhere po duhet me rihartu, me plotësu apo ndryshu.

**Banush Neziri (Njësia e Akreditimit)** – spjegoj në pika të shkurtëra se çka i ka shty që për të bërë këtë projektligj. Duke shtuar se në kohën kur është aprovu ky ligj ndërkohë është formuar njësia, pastaj më kontakte që kanë pas më shtetët e rajonit, BE-ja konkretisht Rregulloja e EA-së, për korporim dhe akreditim të laboratorve testues, kalibrues, trupave certifikues dhe trupave inspektues u kanë sugjeru, se si shtet i ardhshëm nese dëshiron Kosova të jetë pjesë e BE-së, atëhere duhet të behen ndryshime në ligj, përndryshe nuk mund të pranohet si anëtarë të barabartë më shtetët që i kanë të zhvilluara drejtoritë apo institutet e akreditimit, sepse në çdo vend është i ndarë njësia e akreditimit prej njësisë së standartizimit. Më veprimin e ligjit në fuqi neve nuk na ipet e drejta për dhenien e certifikatave të akreditimit sepse vula është e Agjencisë së Standartizimit (në vijim ASK) ku bie në kundërshtim më standardet e BE-së, ISO/IEC 17011 dhe ISO/IEC 17020, tha z.Neziri, duke shtuar më tej se Këshilli i Akreditimit është këshill Këshillimor dhe parashihet që të jetë në përberje të ministrive përkatëse dhe nuk paraqet asnjë implikim tjetër buxhetor më themelimin e tij.

**Safete Hadergjonaj** – duke e vlerësuar si të rëndësishëm këtë projektligj, i shprehu edhe pakenaqësitë e saj për shkak të gjërave mjaft të pa sqaruara. Më tej shtoj se ajo çka është më rendësi të theksohet, është së nuk mund të nënshkruhet marrëveshje multilaterale dhe nuk mund të njihet nga njësitet tjera të akreditimit në regjion, duke iu referuar memos shpjeguese të projektligjit. Edhe të Këshilli nuk është e sqaruar mirë se kush e përben dhe si do të kualifikohen ata anëtarë, çfarë roli do të këtë ky këshillë etj. pasataj kishte vërejtje tek organizimi, ku kjo drejtori po shkëputet nga ASK-ja dhe do të formohet një departament, është e pa kuptueshme. Pastaj shprehu shqetësimin e shpërndarjes së punëtorëve, që disa të mbesin aty e disa të shkojnë në njësinë e re etj. sepse ka rregulla të shërbimit civil dhe të strukturës institucionale se sa punëtorë mund ti këtë një departament apo njësi. Duke përfunduar tha së nuk dihet se a do të mund ti përmirësojm në gjatë amendamentimit të projektligjit.

**Haxhi Gashi** – theksoj se më shqetësuese është çështja e kolizionit të ligjeve, dhe puna parë që është dashur të bëhet, është dashur që të shiqohet se ky projektligj a ka ndikim në fusha që janë të rregulluara më ligje tjera sepse bien në kundërshtim më ligjin e standartizimit dhe më udhëzimin administrativ 2005/15. Në fund tha se e tërëhjek vemendjen në këto pika të cekura si dhe në çështjen e kostos buxhetore të këtij projektligji duke shtuar se nese është dashur të ndryshohet ky ligj, atëherë duhet të ndryshohen edhe ligjet tjera që rregullojnë fusha të njejtë.

**Fatmir Rexhepi** - tha se nuk e di se a është e mjaftueshme të bëhen këto ndryshime për ti arritur ato qëllime për çka thuhet në këtë projektligj. Poashtu shprehu dilemat rreth asaj se me kalimin nga Njësia në Drejtori, të njihet statusi i certifikimit për produkte dhe laborator është e pakapshme, ndërsa shtoj më tej se nëse është çështja e statusit të përfaqësimit në asociacione të atilla ajo është diçka tjetër. Sipas bindjes së tij ky

ndryshim i statusit nuk beson se ka më ndikuar tek ajo që e prezentoj përfaqësuesi i Njesisë së Akreditimit.

**Banush Neziri (Njësia e Akreditimit)** – sqaroj për anëtarët e Komisionit se deri sa nuk ia japim të drejtën më ligj kësaj Njësie që të jap licenca një laborator të punoj sipas standardeve ISO/IEC 17011 dhe ISO/IEC 18025, nuk mund të themi se ai produkt se është i mirë apo i keq. Në fund shtoj se nëse se si shtet dëshrojm që të jemi pjesë e Marveshjes së Stabilizim Asocimit ne duhet ti ngrisim produktet tona në bazë të tri shtyllave, shtyllën e standartizimit, të kalibrimit dhe akreditimit.

**Et'hem Çeku** – pyeti z.Neziri, se me miratimin e këtij ligji a mund të shkakton kolizion tek ligjet tjera?

**Banush Neziri (Njësia e Akreditimit)** – tha se e përfaqëson këtë institucion dhe mund të ju jap spjegime profesionale në lidhje me Njësinë, ndërsa se ky ligj a ka kolizion me ligje tjera, theksoj se nuk mund të arsyetohet.

**Fatmir Rexhepi** – ishte i interesuar të dij se a është e vlefshme vula për certifikim dhe pse tash ka nevoj të ndrrohet vetem emri i institucionit, dhe se si quhet, nuk paraqet asgje, psh. se a e ka emrin Drejtori apo Njësi, më rendësi është që të plotësohen standardet dhe konditat me ligj më zhvillimet e metutjeshme që i bënë Njësia.

**Zef Morina** – ishte e pajtimit që të behet një ndarje në mes të standartizimit dhe akreditimit mirëpo se si do të emërtohet është diqka tjetër dhe e pa rendësishme. Në fund të diskutimit theksoj se e mbeshet projektligjin në parim.

**Haki Shatri** – e përkrahu në parim projektligjin ndërsa ishte i interesuar të dij se sa do të jetë ndryshimi i numrit të punëtorve dhe nga kjo veprimtari a do të realizohen të hyra buxhetore, si dhe kërkoj që ministria të filloj punën për procedimin e ndryshim plotësimi edhe të ligjeve tjera në qoftë se ky projektligj krijon kolizion me ligjet tjera.

**Daut Beqiri (Drejtor i Departamentit Ligjor/Kuvendi i Kosovës)** – theksoj se ministria është dashur që me hartimin e këtij projektligji të bëhet edhe plotësim ndryshimi i ligjit për standardizim për shkak të kolizionit, mirëpo i njoftoj anëtarët e Komisionit se qeveria e ka angazhuar një grup të juristëve për shikimin e kolizionit të ligjeve dhe besoj që do të rregullohet kjo çështje.

**Safete Hadergjona** – pyeti zyrtarët e Departamentit Ligjor të MTI-së, së a kanë marr ndonjë iniciativë për plotësimin e ligjit për standardizim?

**Hakif Jashari (Departamenti Ligjor në MTI)** – u përgjigj shkurt duke thënë se ky projektligj nuk paraqet kolizion me asnjë ligj tjetër, dhe do të shikohen mundësitë e plotësim ndryshimin e ligjit për standardizim. Në fund tha se ky projektligj nuk ka implikime buxhetore.

Bazuar në përmbajtjen e diskutimeve, Komisioni nxori këtë:

### **Rekomandim**

- I. Miratohet në parim projektligji Projektligji për Ndryshimin e Ligjit Nr.02/L-43 për Akreditim;
- II. Obligohet MTI-ja, që të filloj më procedimin për plotësim ndryshimin e ligjeve tjera që implikohen në këtë fushë;
- III. Autorizohet Kryetarja Selmani si Raportuese në emër të Komisionit për seancën e Kuvendit;
- IV. Formohet Grupi Punues për shqyrtimin e këtij Projektligji, pas leximit të parë në seancë, në këtë përbërje: Haki Shatri referues, Sala Berisha – Shala dhe Zef Morina anëtarë;

#### **IV – Të ndryshme;**

**IV.1. Shkresa e Zyrës Ligjore të UNMIK –ut, për tërheqjen e tri projektligjeve, Ligjin Nr.02/L-49, për Ngrohjen e qëndrore, Ligjin Nr.02/L-55, për Minierat dhe mineralet dhe Ligjin Nr.02/L-82, për Hulumtimet gjeologjike ;**

**Kryetarja** – i njoftoi anëtarët e Komisionit më shkresën e Zyrës Ligjore të UNMIK-ut, në lidhje më tërheqjen e tri projektligjeve, Ligjin Nr.02/L-49, për Ngrohjen e qëndrore, Ligjin Nr.02/L-55, për Minierat dhe mineralet dhe Ligjin Nr.02/L-82, për Hulumtimet gjeologjike, në mënyrë që Kuvendi i Kosovës të ndërmarrë veprim të përshtatshëm sa i përket këtyre ligjeve. Kërkoi nga Drejtori i Departamentit Ligjor sqarim në lidhje më këtë shkresë.

**Daut Beqiri (Drejtor i Departamentit Ligjor/Kuvendi i Kosovës)** – theksoj se pas konsultimeve më Zyrën Ligjore të UNMIK –ut, sepse ishte i ngarkuar nga Kryesia e Kuvendit, ka pasuar shkresa për këto tri projektligje, që Komisioni të tërëhjek Rekomandimin datës 06.05.2008, dhe ti dërgohen qeverisë për ridraftim.

Pas debatit të gjerë në Komision, nga deputetët Et'hem Çeku, Zef Morina, Sala Berisha – Shala, Fatmir Rexhepi, Safete Hadergjonaj dhe Haki Shatri, ku shprehen shqetësimin në lidhje më këto projektligje, u theksua se Komisioni më kohë e ka proceduar një Rekomandim për këtë çështje, dhe nxori këtë:

### **Përfundim**

- I. Komisioni qëndron pranë Rekomandimit të datës 06.05.2008, në të cilën thuhet se i Rekomandohet Kryesisë së Kuvendit që të procedojë kërkesën e MEM-it, për tërheqjen e Ligjit Nr.02/L-55, për Minierat dhe mineralet dhe Ligjin Nr.02/L-82 për Hulumtimet gjeologjike, ndërsa Ligjin Nr.02L/49, për Ngrohjen qëndrore ti procedohet për miratim Kuvendit të Kosovës;
- II. Autorizohet stafi mbështetës që ti bashkëngjit një kopje e Rekomandimit të Komisionit të datës 06.05.2008, këtij përfundimi;

#### **IV.2. Kërkesa nga NDI-ja, për monitorimin e ligjeve;**

**Kryetarja** – i njoftoi anëtarët e Komisionit se e kemi një kërkesë për mbështetje të NDI-ja, për monitorimin e ligjeve.

**Zef Morina** – propozoj që të monitorohet Ligji për Rrugët.

**Fatmir Rexhepi** – propozoj që të monitorohet Ligji për Telekomunikacionin dhe Ligji për Miniera dhe Minerale.

Pas diskutimeve, më 6 vota Për, dhe 1 votë Kundër, nxori këtë:

#### **Përfundim**

- I. Mbështetët propozimi i deputetit Zef Morina, për monitorimin e Ligjit për Rrugët;
- II. Ndërsa për kohën dhe agjendën do të kërkohet një situatë e përshtatshme dhe njoftimi do të jetë më kohë;

#### **IV.3. Kërkesa e deputetes Safete Hadergjonaj për rishqyrtimin e Raportit për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbështetje të ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme nr. 02/L-5, të datës 27.05.2008;**

**Kryetarja** – ia dha fjalën deputetes Safete Hadergjonaj, për sqarimin në lidhje me shqetësimin e saj për përpilimin e Raportit për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbështetje të ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme nr. 02/L-5, të datës 27.05.2008.

**Safete Hadergjonaj** – në fillim të diskutimit të kërkoj mirëkuptim në lidhje me këtë çështje, në emër të asaj që ka qenë referuese e Grupit Punues së këtij projektligji. Duke ngritur çështjen në atë se në përpilimin e Raportit për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbështetje të ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme nr. 02/L-5, të datës 27.05.2008, ka ndërhyrë administrata dhe ka bërë ndryshime nga ajo që është miratuar në Komision, në Raportin e datës 15.04.2008. Sepse ka amendamente të cilat nuk janë përfshirë në Grupin Punues e ndërsa në Raport kanë hyrë, ku ua prezentoj me shkrim anëtarëve të Komisionit dhe kërkoj nga Komisioni që si provë ta shiqojn procesverbain e datës 15.04.2008. Duke vazhduar më tej se z.Hadergjonaj, se ka shumë gjera që nuk janë miratuar në Grupin Punues dhe në mbledhjen e Komisionit që është mbajtur më datë 15.04.2008, ndërsa janë përfshirë në Raportin e datës 27.05.2008. Miëpo ajo tha se pajtohet më atë që në Komision jemi marr vesh që stafi të bëjë disa plotësime në lidhje me punën e Këshillit të Agjencisë në bashkëpunim me MTI-në, mirëpo çdo ndryshim që bëhet të paraqitet në Komision. Dhe poashtu i njoftoi anëtarët e Komisionit që këto arsye të kam paraqitur në Komisionin për Buxhet dhe kërkoi edhe nga Komisioni sot të merren parasysh vërejtjet e bëra dhe ta shqyrtojnë edhe një herë në Komision Raportin e datës 27.05.2008.

Bazuar në përmbajtjen e diskutimeve, Komisioni nxori këtë:

#### Përfundim

- I. Përkrahu kërkesën e deputetës Safete Hadergjonaj, që të tërhiqet Raporti për Projektligjin për Plotësim Ndryshim të Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme, Nr.02/L-5, të datës 27.05.2008, nga Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe Komisionin për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthimin;
- II. Të caktohet mbledhje e radhes së Komisionit dhe për rend dite të jetë shqyrtimi i Raportit për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbështetje të ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme nr. 02/L-5, të datës 27.05.2008;

#### **IV.4. Kërkesa e deputetit Zef Morina për dërgimin e një Note Proteste Kryetarit Të Kuvendit për veprimet e Sekretarit të Kuvendit z.Ismet Krasniqi;**

**Kryetarja** - shfaqti shqetësimin në lidhje me sjelljet e Sekretarit të Kuvendit dhe mos përfilljen e deputeve nga ana e tij.

**Zef Morina** – tha se si ka mundësi që Sekretari i Kuvendit, z.Krasniqi të bëjë veprime në kundërshtim me ligjin me sjelljet e tij dhe kërkojm nga Kryetari i Kuvendit dhe Kryesia që të na njoftoi se çfar detyrave ka Sekretari, dhe kujt i përgjigjet sepse ai personalisht na ka pengu për më i realizua punën e Komisionit, pikërisht në Vizitën Zyrtare në Aeroport. Për shkak që nuk ka leju seksionin e transportit të Kuvendit për transportimin e anëtarve të Komisionit. Poashtu potencoj se edhe në Komisionin për Buxhet e ka bërë të njëjten gjë.

Bazuar në përmbajtjen e diskutimeve, Komisioni nxori këtë:

#### Përfundim

- I. Komisioni harton këtë Notë Proteste për shkak se mos të ndodhin në të ardhmen sjellje të tilla dhe kërkon nga Kryesia e Kuvendit që ti kthej përgjigje Komisionit në lidhje me këtë çështje;
- II. Komisioni pyet Kryesinë e Kuvendit së më çfarë kompetence Sekretari e bllokoi punën e Komisionit dhe bën këso sjellje të pa arsyeshme;

Mbledhja përfundoi në orën 13:00;

Kryetare e Komisionit:

Myzejene Selmani